

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Universiteti Prizren "UKSHIN HOTI"
Pranuar me nr. 04.03.2022
Zyra e pranimit, Tel. I parakorit
308
01-102

AGJENCIA PYJORE E KOSOVËS AGENCY FOR FOREST DEVELOPMENT AGJENCIA PYJORE E KOSOVËS AGENCIJA ZA ŠUME KOSOVA KOSOVO FOREST AGENCY
AKTIV - AKTIV - AKTIV
831
4
04.03.2022



Agjencia Pyjore e Kosovës
Agencija za Šume Kosova
Kosovo Forest Agency



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Për bashkëpunim në fushën e pylltarisë

Ndërmjet:

Agjencisë Pyjore të Kosovës (APK)

dhe

Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje të bashkëpunimit (më tutje marrëveshja) mes Agjencisë Pyjore të Kosovës (APK) dhe Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren (Universiteti) (më tutje palët) është realizimi i programit të Menaxhimit të Qëndrueshëm të Pyjeve në sektorin e pylltarisë, bazuar edhe në Strategjinë e Pylltarisë dhe planeve vjetore të menaxhimit të pyjeve.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Kjo marrëveshje përmban kornizën e punës si dhe përgjegjësitë e palëve për realizimin e aktiviteteve të ndryshme në kuadër të Menaxhimit të Qëndrueshëm të Pyjeve, dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve në pyje.

Neni 3

Kohëzgjatja

1. Marrëveshja fillon të zbatohet nga data 15.03.2022 deri më 15.03.2025

Neni 4

Baza e Bashkëpunimit

Bazë e bashkëpunimit për realizimin e kësaj marrëveshjeje janë Legjislacioni i aplikueshëm në Republikën e Kosovës, planet si dhe programet për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve.

Neni 5

Të drejtat dhe përgjegjësitë e Agjencisë Pyjore të Kosovës

1. Të drejtat dhe përgjegjësitë, të cilat do t'i ushtrojë APK si vijon:
 - 1.1. Të lejojë qasje për studentët dhe profesorët e Universitetit, në rastet e praktikave dhe seminareve që duhet të zhvillohen nëpër pyje.
 - 1.2. Sipas mundësive në ndonjë rast eventual, të ndihmojë Universitetin me transport të studentëve dhe profesorëve deri në ndonjë pyll të afërt për marrjen e mostrave për studime dhe praktikave potenciale.
 - 1.3. Sipas mundësive të ndihmojë Universitetin me ndonjë nga pajisjet teknike, që i nevojiten këtij Universiteti për funksionalizimin e laboratorëve.
 - 1.4. T'i ofrojë në shfrytëzim Universitetit një sipërfaqe prej rreth 1ha për funksionalizimin e kopshtit botanik për nevojat e këtij Universiteti.
 - 1.5. T'i mundësojë qasje studentëve dhe profesorëve të Universitetit në laboratorin e shëndetit pyjor, në rastet kur ata do të kenë nevojë.
 - 1.6. T'i jepet qasje studentëve të Universitetit, për marrjen e praktikave më të mira në menaxhimin e kafshëve të egra në ambientet e vendgjuetisë në Blinajë.

Neni 6

Të drejtat dhe përgjegjësitë e Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren

1. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren janë si në vijim:
 - 1.1. Të ofrojë mbështetje profesionale për ndonjë rast eventual, si në rast ekspertizash apo vlerësime profesionale pa pagesë.
 - 1.2. Të ofrojë mbajtje të ligjëratave dhe ndonjë trajnim eventual pa pagesë, për teknikët dhe inxhinierët brenda auditorëve të Universitetit.
 - 1.3. T'i krijojë mundësi APK-së, si shfrytëzimin e laboratorëve për rastet e ekspertizave profesionale.
 - 1.4. Të bëjë pyllëzime të sipërfaqeve të zhveshura me fidane të ofruara nga APK si punë praktike për studentët.

Neni 7
Mospajtimet dhe paqartësitë

1. Nëse njëra nga palët në këtë marrëveshje është e pakënaqur me bashkëpunimin e palës tjetër, atëherë duhet të njoftohen me shkrim. Në raste të tilla, të dy palët do të bëjnë përpjekje për të gjetur mënyra që të vazhdohet bashkëpunimi.

Neni 8
Ndërprerja e parakohshme

1. Secila palë mund ta ndërpresë këtë marrëveshje brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas dhënies së njoftimit me shkrim, nëse pala tjetër nuk është në gjendje apo në ndonjë mënyre pengohet në përmbushjen e obligimeve dhe përgjegjësisive të veta sipas marrëveshjes, duke vënë në rrezik arritjen e objektivave të programit, më kusht që palët janë konsultuar, por pa sukses, në një përpjekje për të eliminuar pengesën.
2. Pas njoftimit për ndërprerjen, siç parashikohet në paragrafin e lartpërmendur, palët menjëherë duhet të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të finalizuar aktivitetet e tyre sipas kësaj marrëveshjeje duke e bërë këtë me shpejtësi dhe në mënyrë të organizuar me qëllim të minimizimit të humbjeve dhe shpenzimeve shtesë.

Neni 9
Modifikimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit

1. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet apo plotësohet me një aneks marrëveshjeje të nënshkruar në mes të palëve dhe vlen për afatin e përcaktuar si në nenin 3 të kësaj marrëveshjeje.
-

Neni 10
Aneksat e marrëveshjes


1. Plani i detajuar i aktiviteteve do të zhvillohet nga të dy palët pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Neni 11
Hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.

PALËT NËNSHKRUESE

Bekim HOXHA/zv. Kryeshef



Agjencia Përqendrore e Kosovës

Prof. Asoc. Dr. Samedin Krrabaj



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren